



Prishtar / Dritaçar Prishtinë / Pristina Tirana / Titograd	20 . 11 . 8	viti god year			
Organ / Organizim Organi / Organizacija Organizacija / Organizatsiya	SKPMSHCK	6977/2018	Shënimi Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	111



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 282 /2018
Datë: 15.11.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, pasi shqyrtoi raportin me rekomandime për Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Shërbimin Korrektues të Kosovës, Këshilli në mbledhjen e njëzet e tretë (XXIII) të mbajtur më datë 15.11.2018 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet raporti me rekomandime i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Shërbimin Korrektues të Kosovës.
2. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës për zbatimin e rekomandimeve në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandim i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Shërbimin Korrektues të Kosovës, është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve në pajtim me këtë vendim dhe raportin.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Menaxherit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të Këshillit.

Eshref SHABANI
Kryetar i Këshillit





Pranuar / Dorëzuar Primiçeno / Prodoto Received / Delivery	20 . 11	8	viti god year
Organ / Njësia Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSSHCK	6977/2018		1140

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TE
LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

NË

SHËRBIMIN KORREKTUES TË KOSOVËS

Prishtinë, tetor 2018

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	3
Funksioni i Mbikëqyrjes.....	4
Objektiva dhe metodologjia e mbikëqyrjes.....	3
Fushat e mbikëqyrjes.....	4
Raporti për mbikëqyrjen në Shërbimin Korrektues të Kosovës.....	5
Organizimi i Brendshëm dhe të Dhënat e të Punësuarve.....	6
Procedurat e Rekrutimit dhe të Avancimit.....	7
Procedurat Disiplinore.....	7
Procedurat e Ankesave.....	8
Procedurat e Vlerësimit.....	8
Procedurat e Pushimeve.....	8
Procedurat e Transferimit.....	8
Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta.....	8
Pezullimi, Ndërprerja dhe Përfundimi i Marrëdhënies së Punës.....	9
Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik.....	9
Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës.....	9
Trajnimi i Nëpunësve Civil.....	10
Vijimi në Punë, Pagat, Shtesat dhe Kompensimet.....	10
Zbatimi i Rekomandimeve dhe Vendimeve të Këshillit.....	10
Shënimet/komentet/konkluzionet e përgjithshëm për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.....	10

HYRJJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Këshilli) mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil të Kosovës.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, Rregullorja Nr. 02/2016 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 02/2014 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike si dhe ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me shërbimin civil.

Këshilli përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

FUNKSIONI MBIKËQYRËS I KËSHILLIT

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike, përmes funksionit të mbikëqyrjes Këshilli bënë mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Për të ushtruar këtë funksion në mënyrën më të mirë, Këshilli ka miratuar “Udhëzuesin për procedurën e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil”, mbi bazën e të cilit edhe harton “Planin e Mbikëqyrjes” në kuadër të të cilit përfshihen një numër i Institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organe të pavarura dhe agjenci qendrore në kuadër të këtyre Institucioneve, plan ky i cili miratohet nga Këshilli në çdo fillim viti.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES

Objektiva e mbikëqyrjes ka për qëllim monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësive për realizimin e objektives sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MBIKËQYRJES

Këshilli, gjatë implementimit të mandatit të tij lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e mbikëqyrjes në kuadër të Divizioneve të Burimeve Njerëzore dhe mekanizmave tjerë të Institucioneve të cilët janë përgjegjës për zbatim të legjislacionit të shërbimit civil.

Në këtë kuadër si pjesë e mbikëqyrjes janë fushat si në vijim:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil

RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË SHËRBIMIN KORREKTUES TË KOSOVES

Këshilli, gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Shërbimin Korrektues të Kosovës, për të vlerësuar drejtë në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Shërbimin Korrektues të Kosovës, përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 02.09.2018, në prezencë të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

- Rregullorja QRK . Nr. 31/2013, pe Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin të Ministrisë së Drejtësisë;
- Akt emërimi i datës 05.03.2013;
- Vendimi i datës 764;
- Vendimi i datës 06.01.2016, për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën „ Drejtor i Drejtorit për Operativë”;
- Vendimi i datës 02.10.2017, për caktimin e ushtruesit detyrës për pozitën „ Drejtor i Qendrës Korrektuese Dubravë”;
- Vendimi i datës 05.09.2018, për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën „ Drejtor i e Burgut te Sigurisë së Lartë ”;
- Formuari për Vlerësimin e rezultateve në punë;
- Vendimi i datës 07.11.2017, për pushim e marrëdhënies se punës, pensionim i nëpunësit civil;
- Vendimi i datës 07.1.2017, për pushim e marrëdhënies se punës, pensionim i nëpunësit civil;
- Njoftimi i datës 22.02.2017, për ndërprerjes se marrëdhëniesh së punës për shkak të pensionimit;
- Vendimi i datës 24.06.2016, për Themelimin e Komisionit përzgjedhës;
- Formuari për Vlerësimin e rezultateve në Punë, për pozitën „ Zyrtar për Shërbime Sociale”;
- Formuari për Vlerësimin e rezultateve në Punë, për pozitën „Zyrtar Ligjor”;
- Kërkesë për pushim e datës 16.08.2017;
- Kërkesë për pushim e datës 31.10.2017;
- Vendimi i datës 19.10.2016;
- Vendimi i datës 19.10.2017;
- Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit i datës 25.04.2017;
- Vendimi i datës 12.04.2017, për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil;
- Vendimi i datës 13.02.2017, për Themelimin e Komisionit Përzgjedhës;
- Autorizimi i datës 29.11.2017, i Ministrisë se Administratës Publike;
- Aktvendimi i datës 27.11.2017;;
- Njoftimi për përzgjedhje i datës 10.02.2017;
- Renditja përfundimtare e kandidateve;
- Përmbledhja e vlerësimin e rezultateve në Punë;
- Vlerësimi individual i kandidateve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohje a ndonjë gjuhë të huaj;
- Renditja përfundimtare e kandidateve;
- Testi me shkrim për pozitën „ Zyrtar Ligjor”;
- Lista e ngushtë ;
- Lista përfundimtare e përzgjedhjes së ngushtë;
- Kërkesa për fillimin e rekrutimit e datës 28.12.2016;
- Regjistrimi i Aplikacioneve të Pranuara;

- Kërkesa për punësim e z, Lulzim Makolli, me shkresat e bashkangjitura;
- Kërkesa për punësim e z, Laura Maxhuni – Qahaja, me shkresat e bashkangjitura;
- Kërkesa për punësim e z, Visar Bikliq, me shkresat e bashkangjitura;
- Kërkesa për punësim e z, Pajtim Aliu, me shkresat e bashkangjitura;
- Kërkesa për punësim e z Mentor Mehmeti , me shkresat e bashkangjitura;
- Vendimi i datës 24.04.2016, për Themelimin e Komisionit përzgjedhës;
- Vendimi për Themelimin e Komisionit përzgjedhës;
- Marrëveshja e datës 23.03.2017, ne mes të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë se Sekuestruar dhe të Konfiskuar dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës, për transferimin e përhershëm, nga pozita „Drejtor i Administratës”, nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë se Sekuestruar dhe të Konfiskuar, në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në pozitën „Drejtor i Drejtoratit për Trajnimin e të Burgosurave dhe të Miturve”;
- Vendimi i datës 12.04.2017;

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në “pyetësor”, ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Shërbimin Korrektues të Kosovës më datë 20.09.2018, e ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren Nr. 31/2013 për Organizim e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Korrektues të Kosovës, dhe se Akt Emërimet e nëpunësve civil janë në pajtim me këtë rregullore. Në këtë institucion janë të lejuar me buxhet Dyqind e pesëdhjetë e gjashtë (256) nëpunës civil, gjashtëdhjetë (65) pozitat janë të lira.

Gjatë vizitës Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar pesë (5) dosje të nëpunësve civil mirëpo si kopje ka marrë tri (3) dosje dhe atë për pozitën „Zyrtar për Shërbimet Sociale”, “Zyrtar për Depozitat e të Burgosurve në Prizren”, “Udhëheqës i Sektorit për Trajnimin e të Burgosurave dhe të Miturve”. Kolegji ka konstatuar se dosjet janë në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civilë.

Ushtruesit e detyrës: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar së në Shërbimin Korrektues të Kosovës, për vitin 2017, ka pasur pozita me ushtrues detyre gjithsejtë tri (3), si ne vijim;

Vendimi i datës 06.01.2016, për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën „Drejtor i Drejtoratit për Operativë”; Vendimi i datës 02.10.2017, për caktimin e ushtruesit detyrës për pozitën „Drejtor i Qendrës Korrektuese Dubravë”; Vendimi i datës 05.09.2018, për caktimin e ushtruesit të detyrës për pozitën „Drejtor i e Burgut te Sigurisë së Lartë ”

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të caktimit të Ushtruesve të detyrës ka gjetur se këto pozita nga emërimi edhe ne ditën e vizitës monitoruese vazhdojnë të mbahen me ushtrues detyre, e që është në kundërshtim me nenin 30 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

REKOMANDIMI 1

Rekomandojmë Drejtorin e Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për eliminimin e shkeljes, dhe që të respektoj të gjitha afatet ligjore lidhur me caktimin e ushtruesit të detyrës ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të nëpunësve civil ka konstatuar se në Shërbimin Korrektues të Kosovës, nuk ka pasur të angazhuar nëpunës civil me marrëveshje për shërbime të veçanta.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Shërbimin Korrektues të Kosovës, gjatë vitit 2017 janë zhvilluar, gjithsejtë katër dhjetë e tri (43), procedura të rekrutimit, prej tyre të anuluar gjashtëmbëdhjetë (16), ndërsa 27 pozita të rekrutuara.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Shërbimin Korrektues i Kosovës, e ka të themeluar Komisionin Disiplino, ndërsa raste në Komisionin Disiplinor, nuk ka pasur gjatë vitit 2017.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Shërbimi Korrektues i Kosovës e ka të themeluar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, sipas Vendimi të datës 24.04.2016 për Themelimin e Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, dhe se në Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, janë paraqitur 2 ankesa, dhe se një është paraqitur në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

E GJETURA 1 Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në SHKK i ka kaluar afati prej dy viteve sipas dispozitave ligjore.

REKOMANDIMI 1

Rekomandojmë Drejtorin e Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për eliminimin e shkeljes, që të themeloje Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 82 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Shërbimin Korrektues të Kosovës, janë bërë vlerësimet e rezultateve të punës për nëpunësit civil për vitin 2017, dhe se nuk ka asnjë nëpunës civil i cili nuk është vlerësuar.

E GJETURA 1 Kolegji ka marrë si provë Vlerësimin e rezultateve në punë për pozitën „Zyrtar për Shërbime Social”, i cili vlerësim është nënshkruar me datën 09.01.2018 nga i vlerësuarin ndërsa vlerësuesi është nënshkruar, me të njëjtën, që është jashtë afatit ligjor të parapara me nenin 3 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 respektivisht nenit 3 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 dhe nenit 10 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Drejtorin e Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme që vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civil, në pajtim 33, paragrafi 1.2 dhe të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe të bëhet brenda afateve ligjore të përcaktuar me dispozitat nenit. 3 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 dhe nenit 10 e Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Shërbimin Korrektues të Kosovës, mbahet evidenca e nëpunësve civil në kopje fizike dhe elektronike. Gjatë vitit 2017, nëpunësit civil kane realizuar 18 pushime mjekësore, ndërsa pushime me pagesë 1, ndërsa pushimit të lehonisë kanë qenë 3.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Shërbimin Korrektues të Kosovës gjatë vitit 2017, ka pasur një (1), rast i transferime përhershëm të nëpunësve civil, në bazë të Marrëveshjes e datës 23.03.2017, e lidhur me mes të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës, për transferimin e përhershëm, nga pozita „Drejtor i Administratës”, nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në pozitën „Drejtor i Drejtoratit për Trajnimin e të Burgosurave dhe të Miturve

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ka të punësuar njëqind e nëntëdhjetë e një (191) nëpunës civil, sipas strukturës etnike janë 174 shqiptar, 11 serb, 4 boshnjak, 2 turq, gjithashtu është konstatuar se prej tyre 126 janë meshkuj ndërsa femra janë 65.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej se njëqind e nëntëdhjetë e një (191) të punësuar në Shërbim Korrektues të

Kosovës prej tyre njëqind e njëzet e gjashtë (126) janë të punësuar, meshkuj ndërsa femra janë gjashtëdhjetë e pesë (65). çka nënkupton se nuk ka numër të barabartë të punësuarve ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6, paragrafi 8 të Ligjit Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore

REKOMANDIM 1:

Rekomandojmë Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, që me rastin e rekrutimit të nëpunësve civil të ri të ketë parasysh respektimin e dispozitave të Ligjit Nr. , 05/L -020 për Barazi Gjinore, në mënyrë që trajtimin i gjinive të jetë i barabartë edhe në aspektin e punësimit dhe numri i të punësuarve të jetë proporcionalisht i barabartë.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, nuk ka pasur asnjë rast pezullimit ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së Punës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, në bazë të dëshmive të ofruara, ka konstatuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, gjatë vitit 2017 nuk ka pasur asnjë nëpunës civil i cili i cili në të njëjtën kohë mban ndonjë post publik i cili bie ndesh me ushtrimin e detyrës së nëpunësit civil.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, në bazë të dëshmive dhe informatave të ofruara nga udhëheqësi i burimeve njerëzore, ka konstatuar se në Shërbimin Korrektues të Kosovës, nuk ka asnjë nëpunës që është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ose është dënuar me vendim të gjykatës,

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komunën e Lipjanit, ka të përgatitur planin e trajnimeve, dhe në trajnimin e nëpunësve civil, i kanë ndjekur gjithsejtë njëzet e tre (23), ndërsa trajnime jashtë venit i kanë ndjekur gjithsejtë dhjetë (10), nëpunës civil.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Shërbimin Korrektues të Kosovës, vijimi në punë mbahet në formë elektronike, të gjitha pagat e nëpunësve civil janë në pajtim me Akt Emërimet po ashtu asnjë nëpunës civil nuk kompensohet me ndonjë shtesë, sipas deklaratës së MP të SHKK.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

14. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Shërbimin Korrektues i Kosovës, ka pranuar njëzet (20) vendim të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe se nuk kanë asnjë vendim të pa zbatuar

Shërbimi Korrektues i Kosovës është monitoruar në vitin 2015, dhe janë dhënë gjithsejtë gjashtë (6) rekomandime, dhe se nuk janë zbatuar nga Shërbimi Korrektues të Kosovës

15. SHËNIMET/KOMENTET/KONKLUZIONET E PËRGJITHSHËM PËR MIBKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit dhe inspektimit të dhënave të dosjeve për fushat e mbikëqyrjes, vlerëson se Shërbimin Korrektues të Kosovës, ka arritur që **pjesërisht** të zbatojë rregullat dhe parimet e legjislacionit të shërbimit civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Shërbimit Korrektues të Kosovës, që **gjetjet me rekomandimet** e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

I dërgohet:

Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
Menaxherit të Personelit në Shërbim Korrektues të Kosovës; dhe
Arkivit të KPMSHCK.